




REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK/DPKPP	Nr. Prot. 01-221/14
Dep. DPK/DPKPP	Br. Prot. Prot No
Nr. i f. l. 02	Data 23.01.2014
Proj. str. mica	Datum
Nr. paqet	Date



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

<b>DATË/A:</b>	23/01/2014
<b>REFERENC-Ë:</b>	AKK-DPK
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Afrim BAJRAKTARI Drejtor i Prokurimit në Universitetin e Prishtinës
<b>CC:</b>	z. Esat KELMENDI Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin e Prishtinës
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinion për Tenderin: "Akomodimi i studentëve dhe profesorëve gjatë mbajtjes së kursit nga lënda e skijimit"



I nderuari z. BAJRAKTARI,

Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1 nënparagrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19, paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin Publik: "Akomodimi i studentëve dhe profesorëve gjatë mbajtjes së kursit nga lënda e skijimit", Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

**OPINION**

Me të cilin kërkohet nga ju si autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin Publik "Akomodimi i studentëve dhe profesorëve gjatë mbajtjes së kursit nga lënda e skijimit" me nr. prokurimi: 90400-14-001-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

## A r s y e t i m

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” më datë 16/01/2014 përmes KRPP-së ka shpallur “Njoftim për Kontratë” për tenderin “Akomodimi i studentëve dhe profesorëve gjatë mbajtjes së kursit nga lënda e skijimit” me nr.prokurimi: 90400-14-001-221. Divizioni i Parandalimit të Korrupsionit në Prokurim Publik në Agjencinë Kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim.

Gjatë ekzaminimit të dokumentacioneve të kësaj procedure të prokurimit, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në të dhëna që nuk janë në përputhje të plotë me procedurat e prokurimit, e të cilat mund të shpien drejt shpërblimit me kontratë në bazë jo meritore.

Në pikën III.2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional, tek “Njoftim për Kontratë” janë kërkuar disa kriterë, ku kriter i fundit është Vërejtje: Qendra e skijimit nuk mundet të jetë më larg se 150 KM nga Prishtina. Përmes kësaj vërejtje, që në këtë rast është paraqitur si kriter, bëhet diskriminim territorial dhe në anën tjetër favorizohen ato që janë në hapësirë më të vogël se 150 KM.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë që bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminim të ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042.

Shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedurat e prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit si dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra

Me respekt!

